



Problema me 3 pikë

1. Cila nga format e mëposhtme mund të formohet me këto 6 tulla?




2. Në sa vende në figurë ndodhen dy fëmijë që janë kapur me njëri-tjetrin me duart e majta?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

1	2	3
4	5	6
7	8	9


3. Në katror shihni shifrat nga 1 deri në 9. Duke shkruar shifrat që ndodhen përgjatë




vijës që fillon nga ylli, krijohet një numër.

Për shembull vija e treguar paraqet numrin 42685.

Cila nga vijat e mëposhtme paraqet numrin më të madh?




4. Sonila dëshiron të shkruajë fjalën KENGU duke përdorur shkronja nga kutitë. Ajo mund të marrë vetëm një shkronjë nga secila kuti.



Cilën shkronjë duhet të nxjerrë Sonila nga kutia 4?


- (A) K (B) E (C) N (D) G (E) U

5. Kur 5 pjesët e treguara bashkohen në mënyrën e duhur, merret si rezultat një drejtkëndësh me rezultatin e shkruar në të. Sa është rezultati i kësaj llogaritjeje?



- (A) 22 (B) 32 (C) 41 (D) 122 (E) 203


6. Një shirit matës është mbështjellë rreth një cilindri.



Cili numër duhet të jetë në vendin ku gjendet pikëpyetja?

- (A) 53 (B) 60 (C) 69 (D) 77 (E) 81

7. Në rrjetë 5 figurat e dhëna mund të lëvizin vetëm në drejtimet e treguara nga shigjetat e zeza. Cila figurë mund të dalë përmes portës G?




- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E


8. Luljeta do të pikturojë muret në dhomën e saj me ngjyrë të gjelbër. Ngjyra e gjelbër është shumë e errët, prandaj ajo e përzier atë me ngjyrë të bardhë.

Ajo provon përzierje të ndryshme. Cila nga përzierjet e mëposhtme do të japë ngjyrën e gjelbër më të errët?

- (A) 1 pjesë e gjelbër + 3 pjesë të bardha (B) 2 pjesë të gjelbërta + 6 pjesë të bardha
 (C) 3 pjesë të gjelbërta + 9 pjesë të bardha (D) 4 pjesë të gjelbërta + 12 pjesë të bardha
 (E) Të gjitha do të jenë njësoj të errëta

9. Mimoza kishte një copë letre. Ajo e palosi atë saktësisht përgjysmë. Pastaj ajo e palosi përsëri


saktësisht përgjysmë. Në fund ajo mori këtë formë . Cila nga format P, Q ose R mund të



ketë qenë forma e fillestare e letrës së saj?

- (A) vetëm P (B) vetëm Q (C) vetëm R (D) vetëm P ose Q (E) secila nga P, Q ose R

10. Është dhënë katrori me segmente të vizatura brenda tij. Segmentet janë vizatuar ose nga kulmet ose nga pikat e mesme të segmenteve të tjera. Duhet të ngjyroset $\frac{1}{8}$ e katrorit të madh. Cila figurat e mëposhtme është kjo ngjyrosje?




Problema me 4 pikë

11. Në një fletë është shkruar numri 5021972970. Joni e preu fletën dy herë dhe mori tre numra. Cila është shuma më e vogël që mund të marrë ai duke mbledhur ata tre numra?


- (A) 3244 (B) 3444 (C) 5172 (D) 5217 (E) 5444

12. Në hartën më poshtë paraqiten tre stacione autobuzash në pikat A, B dhe C. Një turne që nis nga stacioni A për te kopshti zoologjik dhe Porti dhe me kthim në A është i gjatë 10 km. Një turne që nis nga stacioni B për te Parku me vazhdim në kopshtin zoologjik dhe me kthim në B është i gjatë 12 km. Një turne që nis nga stacioni C për te Porti me vazhdim në Park dhe me kthim në C është i gjatë 13 km. Gjithashtu një turne që nis nga kopshti zoologjik për te Parku me vazhdim te Porti dhe me kthim në kopshtin zoologjik është i gjatë 15 km. Sa i gjatë është turneu më i shkurtër nga A në B, në C dhe me kthim në A?




- (A) 7 cm (B) 7.5 cm (C) 8 cm (D) 8.2 cm (E) 8.5 cm

16. Një piramidë me bazë trekëndore është ndërtuar me 10 topa të njëjtë, siç tregohet në figurë. Çdo top ka një nga shkronjat A, B, C, D dhe E. Me secilën shkronjë janë shënuar 2 topa. Figura tregon tri pamje anësore të piramidës. Cila është shkronja në topin me shenjën e pikëpyetjes?



- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E


17. Rina kishte katër kuti të bardha dhe Besa kishte katër kuti të hirta. Ato luajtën një lojë në të cilën vendosnin me radhë një nga kutitë e tyre për të krijuar dy grumbuj të kutive. Rina vendosi së pari kutinë e saj. Cila nga dyshet e grumbujve të kutive nuk mund të kenë formuar ato?



18. Vëllai im i vogël ka një çelës biçiklete me 4 shifra me shifrat 0 deri 9 në secilën pjesë të çelësit, si në figurë. Ai filloi me kombinimin e saktë dhe rrotulloi secilën pjesë me të njëjtën vlerë dhe në të njëjtin drejtim dhe tani çelësi tregon kombinimin 6348.




Cili nga rastet vijuese NUK MUND të jetë kombinimi i saktë i çelësit të vëllait tim?









19. Në një kuti kishte 20 mollë dhe 20 dardha. Genci rastësisht mori 20 kokrra frutash nga kutia dhe Luli mori pjesën tjetër. Cila nga shprehjet e mëposhtme është gjithmonë e saktë?

- (A) Genci mori të paktën një dardhë.
 (B) Genci mori numër të njëjtë të mollave dhe dardhave.
 (C) Genci mori numër të njëjtë të mollave sa edhe Luli.
 (D) Genci mori aq dardha sa Luli mori molla.
 (E) Genci mori më shumë dardha se sa Luli.

20. Ndërmjet pikave X dhe Y ka vetëm një rrugë treni.



Një kompani trenash dëshiron që në të njëjtën kohë çdo ditë, një tren të niset nga X dhe një tren të niset nga Y . Një treni, që lëviz me shpejtësi konstante, i duhen 180 minuta që të bëjë një udhëtim nga X në Y dhe 60 minuta nga Y në X . Për të shmangur përplasjen e trenave, kompania dëshiron të ndërtojë një rrugë të dyfishtë . Ku duhet të vendoset rruga e dyfishtë?

- (A) 
- (B) 
- (C) 
- (D) 
- (E) 

Problema me 5 pikë

21. Hana, Burimi, Erisi, Dioni dhe Edona janë ulur në një tavolinë të rrumbullakët. Hana nuk është ulur pranë Burimit, Dioni është ulur pranë Edonës dhe Burimi nuk është ulur pranë Dionit. Kush është ulur pranë Erisit?

- (A) Hana dhe Burimi (B) Burimi dhe Dioni (C) Dioni dhe Edona (D) Edona dhe Hana
(E) Nuk është e sigurt


22. Matia i kërkoi shefit të mensës recetën për petullat e tij.

Receta e shefit për 100 petulla: 25 vezë, 4 litra qumësht, 5 kg miell dhe 1 kg gjalp.






Matia ka 6 vezë, 400 g miell, 0,5 litra qumësht dhe 200 g gjalp. Cili është numri më i madh i petullave që ai mund të përgatisë duke përdorur këtë recetë?

- (A) 6 (B) 8 (C) 10 (D) 12 (E) 15

23. Figura tregon tre rrota me dhëmbë (ingranazhe) me një dhëmb të zi në secilin prej tyre.



Cila figurë e tregon pozicionin e saktë të dhëmbëve të zinj pasi ingranazhi i vogël ka bërë një rrotullim të plotë në drejtim të akrepave të orës?


- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 

24. Një mollë dhe një portokall peshojnë sa dardha dhe pjeshka. Një mollë dhe një dardhë peshojnë më pak se një portokall dhe një pjeshkë, dhe një dardhë dhe një portokall peshojnë më pak se një

mollë dhe një pjeshkë. Cili nga frutat është më i rëndë?

- (A) molla (B) portokalli (C) pjeshka (D) dardha
(E) nuk mund të përcaktohet

25. Cili është numri më i vogël i katrorëve të hijëzuar që mund të shtohen në figurë për të krijuar



një formë me katër boshte simetrie?

- (A) 1 (B) 9 (C) 12 (D) 13 (E) 21


26. Tre piratë u pyetën se sa monedha dhe sa diamante kishte shoku i tyre Berati. Secili nga të tre e tha të vërtetën për njëren pyetje dhe një gënjeshtër për tjetrën. Përgjigjet e tyre janë të shkruara si në vijim.

- 1) Ai ka 8 monedha dhe 6 diamante
- 2) Ai ka 7 monedha dhe 4 diamante
- 3) Ai ka 7 monedha dhe 7 diamante

Sa është numri i përgjithshëm i monedhave dhe diamanteve që ka Berati?

- (A) 11 (B) 12 (C) 13 (D) 14 (E) 15

27. Çdo raft mban gjithsej 64 decilitra lëng molle. Shishet kanë tre madhësi të ndryshme: të mëdha, të mesme dhe të vogla. Sa decilitra lëng mollë përmban një shishe e mesme?



- (A) 3 (B) 6 (C) 8 (D) 10 (E) 14

28. Një kub i madh ka brinjën 7 cm. Në secilën nga 6 faqet e tij, vizatohen dy diagonalet me ngjyrë të kuqe. Kubi i madh pritet më pas në kube të vogla me brinjë 1 cm.

Sa kube të vogla do të kenë të vizatuar të paktën një vijë të kuqe?

- (A) 54 (B) 62 (C) 70 (D) 78 (E) 86

29. Në një grup me 10 djem dhe vajza, secilit iu dha një letër me një numër të ndryshëm nga 1 deri në 10, të shkruar mbi të. Secili u pyet se cili numër ishte në letrën e tyre dhe të gjithë u përgjigjën me një numër nga 1 në 10. Shuma e përgjigjeve ishte 36. Secila vajzë nuk tha numrin e vërtetë dhe secili djal tha numrin e vërtetë. Cili është numri më i vogël i vajzave që mund të ketë grupi?

- (A) 1 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 7

30. Janë dhënë disa kartona në formë drejtkëndëshi të ndarë në katër fusha të barabarta me forma të ndryshme □, ☆, ●, ▲ të vizatuara në secilën nga fushat. Kartonat mund të vendosen krahas për krahas vetëm nëse të njëjtat forma shfaqen në fushat ngjitur në brinjën e tyre të përbashkët. Nëntë kartona përdoren për të formuar një drejtkëndësh siç tregohet në figurë.

Cili nga kartonat e mëposhtëm NUK ishte përdorur për të formuar këtë drejtkëndësh?

●	▲				
☆	□				

